

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	0904	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	7233-2/25
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	03-	Data Datum Date	03.09.2026
PRISHTINË/A			



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
 Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	31.08.2026
REFERENC-Ë:	25/7233/MMPH
PËR/ZA/TO:	"FIDANI-BETON" SH.P.K. Baballoq, Deçan Bazë e betonit në Baballoq, Deçan
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 25/7233/MMPH, datë 30.09.2025, të parashtruar nga operatori "FIDANI-BETON" SH.P.K. Baballoq, Deçan, për bazën e prodhimit të betonit në Baballoq, Deçan.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin "FIDANI-BETON" SH.P.K. Baballoq, Deçan, për bazën e prodhimit të betonit në Baballoq, Deçan.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary

Nr.: 25/7233/MMPH
Datë: 31.08.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "FIDANI-BETON" SH.P.K. Baballoq, Deçan, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën me nr. prot. 25/7233/MMPH, datë: 30.09.2025, për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 17/4771/681/DMMU, dt. 05.12.2018, për bazën e betonit në Baballoq, Deçan në ngastrën kadastrale nr. 747-3, zona kadastrale Baballoq, Deçan..

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore me nr. prot. 25/7233/MMPH, datë: 30.09.2025, të operatorit "FIDANI-BETON" SH.P.K. Baballoq, Deçan, për bazën e prodhimit të betonit në Baballoq, Deçan, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori

plotësim të dokumenteve me datë 02.07.2026 i ka kërkuar operatorit plotësim të dokumentacionit shtesë si në vijim:

- Lejen ujore nga ARPL për shfrytëzim të ujit për betoniëre;
- Lejen ujore nga ARPL për shkarkim nga betoniera.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori "FIDANI-BETON" SH.P.K. Baballoq, Deçan, për bazën e betonit në Baballoq, Deçan, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.


Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.